




## DITA BOTËRORE E STANDARDEVE – 14 Tetor 2009

Bota po përballet me sfida të rëndësishme. Rritja e çlirimit të gazrave që shkaktojnë efektin serë po rrit temperaturën mesatare të tokës. Si rezultat, priten ndryshime drastike të klimës dhe opinioni shkencor botëror parashikon ndryshime të mëdha në aspektin ekonomik, social dhe mjedisor në planetin tonë.

		
Mr. Jacques RÉGIS <i>IEC President</i>	Dr. Alan MORRISON <i>ISO President</i>	Dr. Hamadoun TOURÉ <i>ITU Secretary-General</i>

Ekspertët kryesorë mbi ndryshimin e klimës kanë vënë përpara një seri zgjidhjesh praktike për të kapërcyer ndryshimin e klimës. Këto zgjidhje përfshijnë standardet teknike të publikuara nga tre organizatat botërore lider të standardizimit ndërkombëtar: Komisioni Ndërkombëtar i Elektroteknikës (IEC), Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO) dhe Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU).

Në raportin e tij të përrurimit të publikuar në 2007, Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimin e Klimës (IPCC) vuri theksin mbi standardet teknike si, ato të publikuara nga IEC, ISO dhe ITU, si një mjet për zbutjen e ndryshimeve klimaterike tani, duke ofruar mundësinë e reduktimit të efekteve të tyre në ardhmen ndërkohë që teknologjitë e reja janë zhvilluar dhe maturuar.

Të tre organizatat botërore janë duke koordinuar punën e tyre për të siguruar që qeveria, biznesi dhe shoqëria janë të pajisur me mjetet e nevojshme për të ndihmuar në luftën kundër ndryshimeve klimaterike globale dhe për të mbështetur zvogëlimin e çlirimit të gazrave që shkaktojnë efektin serë, duke rritur efikasitetin e energjisë, dhe duke lehtësuar zhvillimin e qëndrueshëm.

Standardet e publikuara nga tre organizatat përfshijnë të gjithë sektorët e identifikuar në raportin e IPCC dhe ku ekzistojnë teknologjitë e zbutjes së ndryshimeve klimaterike, politikat dhe masat, kufizimet dhe mundësitë, duke përfshirë furnizimin me energji, transportin, ndërtesat, industrinë, bujqësinë, pyjet dhe trajtimin e mbeturinave.

IEC, ISO dhe ITU ofrojnë një sistem të standardizimit, produkti i të cilëve përfshin standardet për çështjet e mëposhtme që lidhe me luftën kundër ndryshimeve klimaterike:

- Monitorimi dhe matja e çlirimit të gazrave që shkaktojnë efektin serë;
- Matja e gjurmëve të karbonit të rrjeteve dhe produkteve;
- Projektimi dhe ndërtimi i shtëpive dhe vendeve të punës me energji eficientë;
- Vendosja e praktikave të mira përfshirë karakteristikat e mjedisit dhe efikasitetit të energjisë;
- Promovimi i praktikave të mira për menaxhimin e mjedisit dhe të projektimit, si dhe për menaxhimin e energjisë;
- Përhapjen e teknologjive të reja që premtojnë për të ndihmuar në zvogëlimin e efekteve nga ndryshimet klimaterike
- Nxitja për përdorimin e teknologjive të reja për energjinë efektive dhe shërbimet.

Standardet ndërkombëtare ofrojnë për politikëbërësit, industrinë dhe përdoruesit, instrumentat e përbashkët, për të punuar së bashku për kapërcimin e ndryshimeve klimaterike. Tre organizatat partnere gjithashtu, ofrojnë një sistem gjithëpërfshirës në të cilën kombet dhe sektori privat mund të marrin pjesë në vendosjen e prioriteteve për kapërcimin e ndryshimeve klimaterike në vitet që vijnë. Si të tilla, ato ofrojnë zgjidhje praktike plotësisht të mundëshme që të përdoren si pjesë e ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare në vijim të Protokollit të Kiotos.

Standardet IEC, ISO dhe ITU i ofrojnë qeverive dhe industrisë në mbarë botën zgjidhjet më të mira të mundëshme për t'i patur si referencë në çdo vendimarrje politike ose në traktatet e ardhshme mbi klimën. Tre organizatat po punojnë së bashku me organizatat e tjera ndërkombëtare për të siguruar që pjesëmarrësit në Konferencën e ardhshme "Ndryshimi i Klimës dhe Kombet e Bashkuara" më 7-18 Dhjetor 2009 në Kopenhagen, Danimarkë, të jenë plotësisht të vetëdijshëm për zgjidhjet e ofruara nga standarde ndërkombëtare ekzistuese dhe të së ardhmes.

Me kënaqësi njoftojmë të gjithë të interesuarit se të gjitha standardet ndërkombëtare të ISO dhe IEC janë të adoptuara si Standarde Shqiptare (S SH) nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), e cila i siguron këto standarde me kosto shumë më të ulët se e vendeve të tjera duke ruajtur në mënyrë identike përmbajtjen teknike të standardeve.

Standardet e mjedisit dhe të gjitha standardet e fushave të tjera të ekonomisë mund t'i gjeni shumë lehtë nëse klikoni në faqen tonë të internetit [www.dps.gov.al](http://www.dps.gov.al) , rubrika e Katalogut të Standardeve;

me email: [info@dps.gov.al](mailto:info@dps.gov.al);

me tel: +355 4 22 262 55;

me fax: +355 4 22 471 77;

ose mund të na vizitoni në zyrat tona: Rruga "Mine Peza", Nr.143/3.